



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr. 03/L-040 dhe nenet 61 parag. 1.6 dhe 64.3 të Statutit të Komunës, nr. 01-20/01-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, merr:

VENDIM PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË DREJTORISË SË ARSIMIT

Neni 1

z. Agim Blakçori, Master i Pedagogjisë, nga fshati Letanc, Komuna e Podujevës, emërohet

➤ Drejtor i Drejtorisë së Arsimit

Neni 2

I përmenduri në funksionin e cekur emërohet në kohëzgjatje të mandatit të Kryetarit të Komunës, përveç nëse Kryetari i Komunës me vendim të veçantë vendos ndryshe.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Të emëruarit
Zyrës së personelit
Arkivit

Nr. 02-020/05-0001772/19
Podujevë,
09 janar 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 18 paragrafi 7 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149 dhe nenin 7 paragrafët 4 dhe 5 të Rregullores së Ministrisë së Administratës Publike nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Kryetari i Komunës, nxjerr:

VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS AD-HOC PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT SIPAS KONKURSIT TË DATËS 28.12.2018

Neni 1

Për zhvillimin e procedurave të rekrutimit në Shërbimin Civil të Komunës së Podujevës, për dy (2) vende të punës, pozita; *Zyrtar i Pylltarisë 1*, në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, sipas konkursit nr.13-111/01-98604/18 të datës 28 dhjetor 2018, ngritet Komisioni përzgjedhës ad-hoc, në përbërje:

1. Xhafer Sekiraqa, kryesues
2. Vahide Veseli, anëtare
3. Rrahman Cakiqi, anëtar
4. Shpresa Maloku, anëtare
5. Haxhere Ajvazi, anëtare

Neni 2

Komisioni detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, Rregullores 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, dhe aktet tjera përkatëse në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:
Zyrës së Personelit
Anëtarëve
Arkivës

Nr.prot.02-020/04-0003224/19
Podujevë, 15 janar 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 16 dhe 61.1 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, sipas Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale-SMPK të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, merr:

VENDIM

PËR EMRIMIN E KOORDINATORIT DHE ZYRTARËVE PËR AMINISTRIMIN E SISTEMIT PËR MENAXHIMIN E PERFORMANCËS NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për administrimin e Sistemit për Menaxhimin e Performancës në Komunën e Podujevës, emërohen koordinatori dhe zyrtarët komunal, në përbërje:

- | | |
|--------------------------------|---|
| 1. Halit Vërshevc, koordinator | |
| 2. Rizah Muçolli, anëtar | (Parqet, grumbullimi i mbeturinave, deponimi i mbeturinave) |
| 3. Ismet Kadriu, anëtar | (Rrugët, trotualet, ndriçimi publik) |
| 4. Fatmir Latifi anëtar | (Planifikim Urban) |
| 5. Granit Hasani anëtar | (Kanalizim) |
| 6. Ramadan Zymeri, anëtar | (Transporti publik, parkingjet) |
| 7. Sabedin Namani anëtar | (Shërbimet Administrative) |
| 8. Arbresha Bashota, anëtare | (Mirëqenie sociale) |
| 9. Naser Kajtazi, anëtar | (Sistemi i ujësjellës, KUR- Prishtina) |
| 10. Agim Idrizi, anëtar | (Kulturë, rini dhe sporti) |
| 11. Milaim Ajvazi, anëtar | (Emergjencat komunale) |

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit dhe zyrtarëve janë të përcaktuara në dokumentin-Sistemi për Menaxhimin e Performancës komunale të MAPL-së.

Koordinatori dhe zyrtarët janë përgjegjës sipas fushave të përcaktuara në nenin 1 të këtij vendimi.

Neni 3

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për emërimin e koordinatorit dhe zyrtarëve për administrimin e Sistemit për Menaxhimin e Performancës në Komunën e Podujevës nr. Nr. 02-016-77977, i datës 17 tetor 2016.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-020/04-0003652/19
Podujevë, 16 janar 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 17 shkronja k) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ 05/2013 për Parandalimin dhe Ndalimin e Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve (Neni 2 parag. 1.8), nenin 16 dhe 19 parag 1.11 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, në funksion të zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (nr. prot. 16) dhe Komunës së Podujevës (nr. prot. 02-16/01-0004371/19, dt. 18.01.2019) për parandalimin dhe eliminimin e formave të rënda të punës së fëmijëve , merr:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMITETIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN DHE ELIMINIMIN E PUNËS SË FËMIJËVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Themelohet Komiteti Lokal i Veprimit për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve në Komunën e Podujevës, në përbërje:

- | | | |
|----------------------------|-----------|---|
| 1. Zenel Zeneli | kryesues, | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale |
| 2. Selman Gashi | anëtar, | Drejtoria Komunale e Arsimit |
| 3. Xhafer Sekiraqa | anëtar, | Drejtoria Komunale e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural |
| 4. Teuta Ismajli | anëtare, | Drejtoria Komunale e Kulturës, Rinisë dhe Sportit |
| 5. Ardiana Blakçori | anëtare, | Qendra për Punë Sociale |
| 6. Drita Cakiqi | anëtare | Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave - Zyrtari për mbrojtjen e viktimës për komunën përkatëse |
| 7. Faik Mustafa | anëtar, | Shërbimi Sprovues - Zyrtari i shërbimit sprovues |
| 8. Fadil Babatinca | anëtar, | Policia e Kosovës në komunitet |
| 9. Lulzime Hasani | anëtare, | Policia e Kosovës - Njësia kundër dhunës në familje |
| 10. Arzie Potera | anëtare, | Zyra e Punësimit |
| 11. Zenullah Rrustemi | anëtar, | Qendra e Aftësimin Profesional |
| 12. Leotrim Podvorica, | anëtar, | OJQ-të (aktive në mbrojtjen e fëmijëve) |
| 13. Donjeta Sheqiri, | anëtare, | Këshilli i Veprimit Rinor |
| 14. Ganimete Jusufi-Hasani | | Këshilli Komunal Prind-arsimtar |
| 15. _____ | | Asambleja Komunale e Fëmijëve |
| 16. Naim Potoku, | anëtar, | Tryeza për Menaxhimin e Rasteve |

Neni 2

Funksioni, detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit janë të përcaktuar me legjislacionin përkatës, Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Podujevës si dhe Termat e Referencës të miratuara nga Kryetari i Komunës, me theks të veçantë, si vijon:

- Ndërmerr masa për parandalimin, identifikimin, tërheqjen dhe mbrojtjen e fëmijëve të përfshirë në punë të rënda dhe të rrezikshme.
- Në bazë të të dhënave për fëmijët e identifikuar në punë të rënda, harton plane komunale për koordinimin e aktiviteteve ndërinstitucionale të nivelit lokal për mbrojtjen e kësaj kategorie.
- Të gjitha rastet e identifikuara i referohen për trajtim në Tryezën për Menaxhimin e Rasteve.
- Bën vlerësimin e vazhdueshëm të shërbimeve sociale ekzistuese në nivelin lokal dhe përmes rekomandimeve dhe udhëzimeve i propozon kryetarit të komunës për mbështetje të nevojshme.
- Konsolidon raportin mbi situatën e punës së fëmijëve bazuar në raportet e partnereve në nivelin lokal për komunën përkatëse i cili raport përfshinë: të dhëna statistikore, analizën e të dhënave, vlerësimin dhe rekomandimet për kryetarin e komunës.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dorëzohet:

- Anëtarëve të KLV-ve;
- MPMS/DPSF;
- Arkivit të komunës;

Nr.02-020/04-0005644/19
Podujevë, 24 janar 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në implementim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (nr. prot. 16) dhe Komunës së Podujevës (nr. prot. 02-16/01-0004371/19, dt. 18.01.2019) për parandalimin dhe eliminimin e formave të rënda të punës së fëmijëve , miraton:

TERMAT E REFERENCËS

PËR

KOMITETIN LOKAL TË VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN DHE ELIMINIMIN E FORMAVE TË RËNDA TË PUNËS SË FËMIJËVE

Neni 1

Roli i Komitetit Lokal të Veprimit (KLV)

1. Komiteti Lokal i Veprimit ndërmerr masa për parandalimin, identifikimin, tërheqjen dhe mbrojtjen e fëmijëve të përfshirë në punë të rënda dhe të rrezikshme.
2. Komiteti Lokal i Veprimit, në bazë të të dhënave për fëmijët e identifikuar në punë të rënda, harton plane komunale për koordinimin e aktiviteteve ndërinstucionale të nivelit lokal për mbrojtjen e kësaj kategorie.
3. Dokumenton në vazhdimësi trendët e shtrirjes së punës së fëmijëve në komunën përkatëse.
4. Bën vlerësimin e vazhdueshëm të shërbimeve sociale ekzistuese në nivelin lokal dhe përmes rekomandimeve dhe udhëzimeve i propozon kryetarit të komunës që të ofrojë mbështetjen e nevojshme.

Neni 2

Krijimi dhe përbërja e KLV-së

1. Komiteti Lokal i Veprimit për parandalimin dhe eliminimin e formave të rënda të punës së fëmijëve, themelohet në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2013 për Parandalimin dhe Ndalimin e Formave të Rënda të Punës së Fëmijëve.
2. Anëtarët e Komitetit Lokal të Veprimit janë zyrtarë të lartë të autoriteteve lokale, përfaqësues të partnerëve social dhe të shoqërisë civile.
3. Udhëheqës i Komitetit Lokal të Veprimit është Drejtoria Komunale përgjegjëse, në bashkëpunim të ngushtë me Qendrën për Punë Sociale.
4. Komiteti Lokal i Veprimit përbëhet nga:
 - 1) Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
 - 2) Drejtoria Komunale e Arsimit;
 - 3) Drejtoria Komunale e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
 - 4) Drejtoria Komunale e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
 - 5) Qendra për Punë Sociale;
 - 6) Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave - Zyrtari për mbrojtjen e viktimës për komunën përkatëse;
 - 7) Shërbimi Sprovues - Zyrtari i shërbimit sprovues;
 - 8) Policia e Kosovës në komunitet;
 - 9) Policia e Kosovës - Njësia kundër dhunës në familje;
 - 10) Zyra e Punësimit;
 - 11) Qendra e Aftësimin Profesional;
 - 12) OJQ-të (aktive në mbrojtjen e fëmijëve);
 - 13) Këshilli i Veprimit Rinor;
 - 14) Këshilli Komunal Prind-arsimtar;
 - 15) Asambleja Komunale e Fëmijëve.
 - 16) Tryeza për Menaxhimin e Rasteve

Neni 3

Kompetencat e KLV-së

1. Komiteti Lokal i Veprimit mblidhet gjatë vitit të parë një herë në muaj, ndërsa pas një viti çdo 3 muaj në takimet e rregullta apo më shpesh në takime të jashtëzakonshme, nëse iniciohen nga anëtarët ose nëse thirren nga udhëheqësi për të: a/ shqyrtuar të dhënat e konsoliduara nga QPS-të dhe partnerët e tjerë; b/ shqyrtuar mundësitë dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave që kanë të bëjnë me eliminimin e PF-së; c/ parë nëse informatat për shkeljen e ligjeve lidhur me punën e fëmijëve i janë vënë në dispozicion nëpunësve zbatues të ligjit dhe të sistemit ligjor.

2. Komiteti Lokal i Veprimit do të sigurojë që të gjithë partnerët dhe anëtarët e këtij komiteti të mbajnë shënime për veprimet e ndryshme të zbatuara nga ata (p.sh. shkollat, qendrat shëndetësore, inspektorët e punës, policia në bashkësi do të mbajnë shënime mbi fëmijët e referuar nga vet ata në QPS-ë, ofruesit e shërbimeve do të mbajnë shënime për shërbimet e ofruara, etj.).
3. Të gjitha rastet në rrezik të mesëm ose të lartë të rasteve të fëmijëve të përfshirë në punë të rënda do të referohen dhe trajtohen nga Tryeza për Menaxhimin e Rasteve.
4. Komiteti Lokal i Veprimit merr vendime me votim, nëse janë së paku një më tepër se gjysma e anëtarëve të Komitetit.
5. Komiteti Lokal i Veprimit mund të formojë grupe punuese për nevoja të monitorimit të punës së fëmijëve.
6. Komiteti Lokal i Veprimit harton planin vjetor të veprimit për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve për komunën përkatëse, duke përfshirë edhe koston financiare e cili duhet të aprovohet nga institucionet komunale.

Neni 4

Pjesëmarrja në takimet e KLV-së

1. Anëtarët e rregullt të Komitetit Lokal të Veprimit e kanë të obliguar pjesëmarrjen në takimet e KLV-së.
2. Komiteti Lokal i Veprimit mund të ftojë në takimet e veta përfaqësues të institucioneve të ndryshme: OQ-të, OJQ-të si dhe nga komunitetin, varësisht nga vlerësimi i nevojave.
3. Një përfaqësues nga TMR do të marrë pjesë në takimet e Komitetit, si dhe një përfaqësues nga Komiteti do të marrë pjesë në takimet e TMR-së me qëllim që këto mekanizma të kenë ndërlidhje dhe ndjekje të rasteve.
4. Për të përmbushur përgjegjësinë e vet KLV-ja mund të kërkojë këshillime dhe mbështetje profesionale nga niveli qendror.

Neni 5

Sekretaria e KLV-së

1. Komiteti Lokal i Veprimit mund të caktojë një koordinator i cili do të ketë rolin e sekretarisë së KLV-së.
2. Koordinator i KLV-së do të veprojë në emër të udhëheqësit të KLV-së.

Neni 6
Mënyra e raportimit

1. Komiteti Lokal i Veprimit konsolidon raportin mbi situatën e punës së fëmijëve, bazuar në raportet e partnerëve në nivelin lokal për komunën përkatëse, raport i cili përfshin: të dhëna statistikore, analizën e të dhënave, vlerësimin dhe rekomandimet për kryetarin e komunës.
2. Institucioni udhëheqës i KLV-ve raportin e konsoliduar vjetor për fëmijët e përfshirë në punë të rënda do ta përcjellë çdo fund vit në Departamentin e Politikave Sociale dhe të Familjes/MPMS.

Neni 7
Dokumentacioni mbështetës për KLV-në

1. Udhëzimi Administrativ nr. 05/2013 për Parandalimin dhe Eliminimin e Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve në Kosovë;
2. Standardet minimale për punët e rënda të fëmijëve;
3. Lista e punëve të rrezikshme të fëmijëve në Kosovë për ndalim të menjëhershëm;
4. Udhëzuese për zhvillimin e procesit për parandalimin dhe eliminimin e punës së rëndë të fëmijëve;
5. Format standarde të raportimit;
6. U.A. Nr. 01/2012 për sistemimin e punëve të lehta dhe të ndaluara për personat nën moshën 18.

Podujevë, 24 janar 2019

Kryetari i Komunës
Agim Veliu





KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 dhe nenin 61 parag 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

VENDIM PËR CAKTIMIN E USHTRUESIT TË DETYRËS SË MENAXHERIT TË ZYRËS SË PROKURIMIT NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

z. Rasim Fejza, shef i Sektorit të shërbimeve publike në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, caktohet ushtrues i detyrës së Menaxherit të Zyrës së Prokurimit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

I përmenduri sipas nenit 1 të këtij vendimi caktohet ushtrues i detyrës deri në rekrutimin e zyrtarit përkatës sipas procedurës në pajtim me legjislacionin në fuqi, përkatësisht deri në marrjen e një vendimi tjetër.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Zyrës së Personelit
Të caktuarit
Arkivit

Nr. 02-020/05-0005707/19
Podujevë, 25 janar 2019



Kryetari i Komunës
Agim Veliu